

VENDIM
Nr. 291, datë 9.10.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 16.11.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘IDI 2005’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘KAMIÇAN’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1860 kw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/14 prot., datë 4.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kamiçan’, me kapacitet të instaluar 1860 kw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 16.11.2020, të ndryshuar, vendosi të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kw, për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitojë në ERE brenda datës 25.10.2023, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit uhor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

- ERE, me shkresën me nr. 2033/10 prot., datë 22.9.2023 i kujtoi shoqërisë detyrimin e lënë në pikën 2, germa “b”, të vendimit të Bordit nr. 188/2020, që brenda datës 25.10.2023, duhet të depozitojë lejen e rinovuar të përdorimit të burimit uhor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2033/12 prot., datë 29.9.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit uhor sipërfaqësor me nr. serie 000128, nr. 642 prot., datë 5.7.2023, të miratuar me vendimin nr. 23, datë 29.6.2023, të Këshillit të Basenit Uhor Seman për përdorimin e burimit uhor për HEC “Kamiçan”, me një afat 5-vjeçar, deri më 29.6.2028.

- Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, germa “b”, të vendimit nr. 188/2020, të ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe, po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit uhor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan” brenda datës 29.6.2028.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. të depozitojë në ERE:

b) brenda datës 29.6.2028, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit uhor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti